



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/40 Nr. i faq./Br.str./No.pg 77
Data/Datum/Date 29.4.2025

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja (h) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nenit 14 paragrafi 8 pika 8.1 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar, nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, propozimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit me Nr. Reference 04/554 të dt. 07.04.2025, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2025, miraton këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP)

- Caktohet** komisioni për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar (IEAA-AP) në komunën e Rahovecit, të cilët konkurrojnë në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim, në këtë përbërje:
 - Lulzim Krasniqi, udhëheqës i Sektorit për Arsim, në Drejtorinë për Arsim, kryesues,
 - Vjollca Vuçitërna, drejtoreshë në IAAP "Selajdin Mullabazi – Mici" në Rahovec, anëtare,
 - Anëtari i tretë është nga MASHTI-i, sipas Rregullores (QRK) Nr. 19/2024.
- Detyra e komisionit është intervistimi i kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin e cekura në pikën 1 të këtij vendimi dhe në bazë të pikëve të fituara, bën ranglistën e kandidatëve dhe i rekomandojnë Kryetarit të Komunës emërimin e kandidatëve më të suksesshëm për drejtor/eshë apo zëvendësdrejtor/eshë e IEAA-AP sipas konkursit.
- Obligohet komisioni përzgjedhës që punët t'i kryejë duke u bazuar në ligjet dhe në aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Mandati i komisionit përzgjedhës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është 1 (një) vjet.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Arsim,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.40/25
Datë:29.04.2025



Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit